



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË  
REAL BAILIFF SERVICE SH.P.K

NIPT L71710039A

Nr.516 Regj  
Nr. 2731 Prot

Tiranë, më 21.06.2019

URDHËR  
“PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE”

Drejtuar: Qendra Kombetare e Biznesit  
Adresa: Tirane  
Per dijeni: Rafaelo Resort Sh.p.k NIPT L88008503O, Administrator Z. Eduart Gjinaj  
Adresa: Lezhe, Shengjin, Rruga e Portit, Ish Kampi i Punetoreve, (Tel 672036785),  
Per dijeni: Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor  
Adresa: Rr. “Aleksander Moisiu”, Nr.80, Tiranë,

Unë, Resul Alushani, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbardimit Privat “REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Vendimi Nr.230 (1066), datë 26.11.2018 nga Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Shkodër, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbardimore Nr. 516, Datë 11.01.2019 kërkesën e kreditorit Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor ndaj debitorit Rafaelo Resort Sh.p.k NIPT L88008503O, në lidhje me titullin ekzekutiv “Vendimi per Gjobe Nr. 001065-5, datë 01.08.2018, te mbajtur sipas Proçesverbalit Nr. 001065-2, datë 01.08.2018, i Inspektoriatit Shtetëror Shendetesor Vlore”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 166 Prot, Datë 11.01.2019, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Vendimi Nr.230 (1066), datë 26.11.2018, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA:

Debitori Rafaelo Resort Sh.p.k NIPT L88008503O, nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të lajmërimit per ekzekutim vullnetar te detyrimit.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestro mbi kreditë e debitorit Rafaelo Resort Sh.p.k NIPT L88008503O, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile, si dhe të neneve 31 pika (b), 32 pikat (c) dhe 46 (paragrafi i 1-rë) të Ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbardimor Gjyqësor Privat”, me qëllim ekzekutimin e titullit ekzekutiv,

URDHËROJ:

1. Qendra Kombetare e Biznesit, të vendose sekuestron konservative mbi aktivet e pales debitore **Rafaelo Resort Sh.p.k NIPT L88008503O**, me qëllim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregetar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.
4. Ky urdhër ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile, kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

“REAL BAILIFF SERVICE” Sh.p.k  
PËRMBARUESI GJYQËSOR  
Resul ALUSHANI

